



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 4/4 prot

Tiranë , më 05.01.2023

VENDIM

Nr. 1 , Datë 05.01.2023

“PËR

**MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE TË MENJËHERSHME TË
PUNONJËSVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHËSHME DHE
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PUBLIK PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT
TË KRIZËS”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika c, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.115 / 2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “ Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “ Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, VKM-së Nr.898 datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithëshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës; Vendimit të Senatit Akademik – UT Nr.1 datë 05.01.2023 pas miratimit nga anëtarët e Bordit të Administrimit, Bordi i Administrimit :

Vendosi:

1. Miratimin e fondit të mbështetje financiare të punonjësve të Universitetit të Tiranës sipas VKM-së nr 898 datë 29.12.2022. “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithëshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për zbutjen e impaktit të krizës”
2. Burimi i financimit për këtë mbështetje financiare të jenë të ardhurat e Universitetit të Tiranës për vitin 2022.Pagesat të kryhen nga llogaria 606/6 (Transferime tek individët).
3. Ngarkohet Administratori dhe strukturat përgjegjëse në Universitetin e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi. Administratori i UT-së, dhe Administratorët e njësive kryesore të kryejnë procedurat e nevojshme për të mbështetur zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

